



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FUSHË-ARRËZ
KËSHILLI BASHKIAK

Komisoni i Përhershëm i Mirëqenies Sociale Barazisë Gjinore Mosdiskriminimit
dhe të Drejtave të Njeriut

Fushë-Arrëz, më 28.01.2026



Nr. 200/ Prot

RAPORT VENDIMMARRJE

Drejtuar: Këshillit të Bashkisë

Lenda: Vendim për shqyrtimin e projekt vendimit nr.3, datë 16/01/2026, relacionit e dokumentat shoqërues në lidhje me Projekt vendimin "Përcaktimin e kriterëve për dhënie të Ndiemes Ekonomike për familjet aplikuese të cilat nuk janë shpallur fitues nga sistemi i pikëzimit dhe që do të trajtohen, nëpërmjet përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar (6%) për Ndiemen Ekonomike dhe dhënie të Ndiemes Ekonomike për familjet në nevojë"

Analiza ligjore: Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", të nenit 7, të ligjit nr. 57/2019, datë 18.07.2019, "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, si dhe të Kreut IV, pika 2 të Vendimit nr. 597, datë 04.09.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e procedurave, dokumentacionit dhe masës mujore të ndihmës ekonomike", të ndryshuar, dhe Vendimit nr. 5, datë 23.02.2018, "Mbi miratimin e kriterëve për familjet në nevojë", me përjashtim të pikave 1, 6 dhe 7 që do të trajtohen me ndihmën ekonomike duke përdorur deri në 6% të fondit të ndihmës ekonomike. Sektori i Çështjeve Sociale, I propozon Këshillit të Bashkisë Fushë-Arrëz P/Vendimin për kriteret e 6%

Situata aktuale e funksionit: Përmes fondeve të alokuara në këtë program buxhetor, synohet bashkia në harmoni me politikat kombëtare zhvillon programe për uljen e varfërisë. Në këtë drejtim bashkia ka punuar gjatë vitit në objektiva si: Buxheti i alokuar në këtë program buxhetor është përdorur nga bashkia për përmirësimin e shërbimeve që i ofrohen komunitetit për kujdesin social.

Situata financiare: Bashkia propozon kriteret si mëposhte:

1. Të gjitha familjet, të cilat kanë aplikuar nëpërmjet regjistrit elektronik për ndihmen ekonomike dhe nuk janë shpallur fitues nga sistemi i pikëzimit.
2. Familje me kryefamiljare femra në vështirësi ekonomike dhe sociale, (të veja, të divorcuara).
3. Familje me shumë fëmijë.
4. Familje me fëmijë jetim.
5. Familje me kushte të vështira ekonomike që në përbërjen e tyre kanë dy ose më shumë TEmijë që vazhdojnë studimet jashtë vendbanimit.
6. Familje të cilat nuk kanë asnjë të punësuar.
7. Familje me anëtarë me sëmundje kronike.
8. Familjeve një herë në tre muaj t'u bëhen riaplikim në skemën e NE.
9. Përfituesit nga çdo lloj kriteri, të masës së ndihmes ekonomike prej 6%, duhet të jetë banues fizikisht në Bashkinë Fushë-Arrëz.
10. Familje me kushte të vështira ekonomike që në përbërjen e tyre kanë anëtarë me aftësi të kufizuara apo invalid pune.
11. Persona që jetojnë vetëm, të moshuar dhe të rinj me probleme sociale.
12. Familje që kanë në përbërje një ose më shumë anëtarë me aftësi të kufizuara, sëmundje të rënda.

Drejtoria / Sektori përgjegjës:

Drejtoria e Çështjeve Sociale ka relatuar përpara komisionit për Projekt Vendimin

Monitorimi dhe raportimi : Komisioni i Përhershëm i Mirëqenies Sociale Barazisë Gjinore Mosdiskriminimit dhe të Drejtave të Njeriut dhe të gjithë këshilltarët do të monitorojnë zbatimin e buxhetit dhe do të thërrasin sa herë të jetë nevojshme Drejtoria e Çështjeve Sociale për zbatimin e projektit.

Impakti social / grupet që preken: Impakton jetën të gjitha shtresave të varfra në të gjithë territorin të bashkisë

A është objekt i konsultimit publik: Nuk është objekt konsultimi publik

Komisioni i Përhershëm i Mirëqenies Sociale Barazisë Gjinore Mosdiskriminimit dhe të Drejtave të Njeriut, i mbledhur me datën 27/01/2026, shqyrtoi projekt vendimit nr.3, datë 16/01/2026, relacionit e dokumentat shoqërues në lidhje me Projekt vendimin nr.3, datë 16/01/2026, relacionit e dokumentat shoqërues në lidhje me Projekt vendimin “Përcaktimin e kriterëve për dhënie të Ndihmes Ekonomike për familjet aplikuese të cilat nuk janë shpallur fitues nga sistemi i pikëzimit dhe që do të trajtohen, nëpërmjet përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar (6%) për Ndihmen Ekonomike dhe dhënie të Ndihmes Ekonomike për familjet në nevojë” paraqitur nga Kryetari i Bashkisë.

Pas shqyrtimit të projekt vendimit dhe materialeve shoqëruese,

Komisioni me shumicë votash,

VENDOSI

1. T'i propozojë Këshillit Bashkiak:

- a) kalimin e projektaktit në Mbledhjen e Këshillit për vlerësim të mëtejshëm dhe shqyrtim
- b) miratimin e projektaktit

Bashkëlidhur argumentat e vendimmarrjes dhe mendimi i pakicës i paraqitur në procesverbalin e mbledhjes së Komisionit

Tereze Dema Kryetar i Komisionit
(emri, mbiemri, firma)

Reyhan Rza Sekretar i Komisionit
(emri, mbiemri, firma)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FUSHË-ARRËZ
KËSHILLI BASHKIAK

Komisioni i Përhershëm i Mirëqenies Sociale Barazisë Gjinore Mosdiskriminimit dhe të Drejtave të Njeriut



Nr. 200 prot.

Fushë-Arrëz, më 28.01.2026

PËR : KËSHILLIN E BASHKISË

FUSHË-ARRËZ

Lënda: Relacion për projekt/vendimin “Miratimi i Kritereve për dhënien e Ndihmës Ekonomike duke përdorur deri në 6% të fondit për vitin 2026”, që do t’i paraqitet Këshillit të Bashkisë për shqyrtim në mbledhjen e tij të datës 30.01.2026.

Ne zbatim të ligjit 139/2015 “Për vetëqerisjen vendore”, i ndryshuar, Rregullores për Funkcionimin e Këshillit të Bashkisë, Komisioni i Përhershëm i Mirëqenies Sociale, në mbledhjen e datës 28.01.2026 me pjesëmarrjen e anëtareve: Tereze Dema, Franc Doda dhe Pavlin Qafa, mori në shqyrtim projektin e miratimit të Kritereve për dhënien e Ndihmës Ekonomike duke përdorur deri në 6% të fondit për vitin 2026, paraqitur nga Sektori i Shërbimit Social.

Anëtarët e Komisionit janë njohur me projektin përmes materialit shkresor, nderkohe në mbledhjen e komisionit, shpjegimet i dha Përgjegjëse në Drejtorinë e Çështjeve Sociale, Zj Klotilda Curri, e cila shpjegoi se kriteret për dhënien e Ndihmës Ekonomike duke përdorur deri në 6% të fondit për vitin 2026 janë përpiluar bazuar në ligjin për kriteret e përfitimit. Ajo thekson se mbetet persesi kriteri i shtuar nga keshilli bashkiak një vit më parë lidhur me banimin fizik të personave dhe familjeve që përfitojnë 6% të ndihmës ekonomike.

Kriteret e propozuara për përfitimin e masës së ndihmës ekonomike prej 6% për vitin 2026 do të jënë:

1. Të gjitha familjet, të cilat kanë aplikuar nëpërmjet regjistrit elektronik për ndihmën ekonomike dhe nuk janë shpallur fitues nga sistemi i pikëzimit.
2. Familje me kryefamiljare femra në vështirësi ekonomike dhe sociale, (të veja, të divorcuara).
3. Familje me shumë fëmijë.
4. Familje me fëmijë jetim.
5. Familje me kushte të vështira ekonomike që në përbërjen e tyre kanë dy ose më shumë fëmijë që vazhdojnë studimet jashtë vendbanimit.
6. Familje të cilat nuk kanë asnjë të punësuar.

7. Familje me anëtarë me sëmundje kronike.
8. Familjeve një herë në tre muaj t'u bëhen riaplikim në skemën e NE.
9. Përfituesit nga çdo lloj kriteri, të masës së ndihmes ekonomike prej 6%, duhet të jetë banues fizikisht në Bashkinë Fushë-Arrëz.
10. Familje me kushte të vështira ekonomike që në përbërjen e tyre kanë anëtarë me aftësi të kufizuara apo invalid pune.
11. Persona që jetojnë vetëm, të moshuar dhe të rinj me probleme sociale.
12. Familje që kanë në përbërje një ose më shumë anëtarë me aftësi të kufizuara, sëmundje të rënda, të cilët nuk përfitojnë nga KMCAP-ja dhe janë në kushtë të vështira socio-ekonomike.

Franc Doda anëtar i komisionit, jemi dakord me kriteret për dhënien e Ndihmës Ekonomike duke përdorur deri në 6% të fondit për vitin 2026, nese do te jete nevoja per ndonje ndryshim ne ketu jemi, argumentojme ne baze edhe te verifikimeve ne terren dhe bejme ndryshimet e duhura.

Franc Doda anëtar i komisionit, thote se duhet te kontrollohen individet ku jetojne dhe te pershtaten kriteret ne baze te nevojave , kuptohet bazuar ne ligj.

Pas diskutimit anëtarët e komisionit, me shumicë votash, ranë dakord me projektin për Kriteret dhënies së Ndihmës Ekonomike duke përdorur deri në 6% të fondit për vitin 2026 të paraqitur dhe kërkuar miratimin e tij nga Këshilli Bashkiak në mbledhjen plenare të datës 30.01.2026 duke kërkuar edhe mendime dhe propozime të tjera të këshilltarëve të pranishëm.

Duke kërkuar bashkepunimin tuaj!

Franc Doda



Pavlin-Qafa



Tereze Dema

